



Njësia e Jetësimit

Dr. Elaine Kamarck
Për Kryeministrinë
11 Nëntor, 2013



Kurrikulum:

- Lexime: “Deliverology: From idea to implementation,” nga Michael Barber, Paul Kihn and Andy Moffit, publikuar nga McKinsey & Company, 2001.
- “Central Control and policy implementation in the UK: A Case Study of the Prime Minister’s Delivery Unit.” nga David Richards & Martin Smith, publikuar në *Journal of Comparative Policy Analysis” Research and Practice*, 24 Janar, 2007. *Faqe 337 – 343.*

+ Historia e Njesisë së Jetësimit

- U krijua në 2001 gjatë mandatit të Tony Blair si Kryeministër, me qëllim që ai të kishte “një shkallë kontrolli formale dhe të drejtpërdrejtë mbi jetësimin e politikës.”
- Cituar nga Richards & Smith, Ibid.

+ Qëllimi i Njesisë së Jetësimit

- “Që në fillim, qeveria Blair është munduar të përcaktojë një axhendë të qartë me një koordinim qendror, e cila të mos vihej në rrezik nga departamentalizmi i sistemit politik britanik, si edhe të ndreqë çekuilibrin e burimit midis qendrës dhe departamenteve.”
- Nga Richards & Martin, fq. 331.

+ Qëllimi i Njesisë së Jetësimit

- “Pas pesë vitesh në qeveri, di shumë mirë një gjë, që duke aprovuar një legjislacion ose duke mbajtur një fjalim nuk do zgjidhim problemin e vandalizmit mbi pasuritë, nuk do rrisim standartet në shkollat e mesme, nuk do kujdesemi për të moshuarit në rrezik.”
- (Kryeministri Tony Blair, cituar në 2001 në Richards and Martin, fq. 333)

+ Përkufizimi i një njësie jetësimi

■ "...një grup i vogël njerëzish të përkushtuar të cilët fokusohen ekskluzivisht në krijimin e impaktit dhe përmirësimin e rezultateve."

■ Cituar në Barber et. al. OpCit. Fq. 33

+ Roli i një njësie jetësimi (Barber et. al. plus Kamarck)

- 1) Cakton Drejtimin
- 2) Krijon Skuadra
- 3) Krijon Parametra për të Matur Ecurinë
- 4) Krijon plane dhe buxhete realiste
- 5) Monitoron Ecurinë
- 6) Shpërblen Suksesin
- 7) Nxjerr mësim nga Dështimi

+ Njësia e jetësimit:

- Duhet “të qëndrojë jashtë hierarkisë që menaxhon sistemin.”
- “Ajo nuk duhet të menaxhohet nga asnjë nga personat ose organizatat që kërkon të influencojë, dhe as të menaxhojë në mënyrë të drjetpërdrejtë këta persona ose organizata.”
- Ajo duhet të jetë e pavarur në mënyrë që të jetë një “mik kritik i cili përcjell mesazhe të vështira, por edhe mbështet besimin dhe kredibilitetin me aktorët në sistem”
- Duhet të ketë “linja të qarta komunikimi dhe marrëdhënie- jeje me departamentet që ajo mbikqyr.”
- Barber, et.al. faqe 35

+ Versioni amerikan i Njesisë së Jetësimit

- U krijua në vitin 1993 si pjesë e Zyrës së Zv. Presidentit
- Stafi përbëhej nga punonjës civilë profesionistë të cilët punonin në grupe.
- U mbajt jashtë procesit të buxhetimit formal në mënyrë që, përveç problemeve financiare, të fokusohej në problemet e performancës.
- Ekzistoi gjatë gjithë 8-vjeçarit të Administratës Clinton/Gore, edhe pse skuadrat e saj ndërroreshin me kalimin e kohës.